



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:029353

Datë: 18.03.2025

Numri i dokumentit: 07006490

P.nr.22/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me zyrtaren ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit N.C nga fshati ..., Komuna Vushtrri, tani me vendbanim në Prishtinë, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. Veton Uka, për shkak të veprës Kanosja nga neni 181 par. 3 e lidhur me par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.2179/2022 të datës 01.02.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 13.03.2025, në praninë e Prokurores së Shtetit Vyrtyte Gervalla, të pandehurit N.C, mbrojtësit sipas detyrës zyrtare av. Veton Uka dhe të dëmtuarve F.C, O.G dhe A.U, në të njëjtën datë mori, ndërsa me datë 18.03.2025 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.2179/2022 të datës 01.02.2023, dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit N.C nga fshati ..., Komuna Vushtrri, me numër personal ..., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 3 e lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Për shkak të tërheqjes së Prokurorit të Shtetit nga ndjekja penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

Të dëmtuarit: F.C, O.G dhe A.U, për realizimin e kërkesave pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2179/2022 të datës 01.02.2023, kundër të pandehurit N.C nga fshati ..., Komuna Vushtrri, tani me vendbanim në Prishtinë, për shkak të veprës Kanosja nga neni 181 par. 3 e lidhur me par. 1 të KPRK-së,.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.03.2025, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurorja e Shtetit Vyrtyte Gervalla, i pandehuri N.C së bashku me mbrojtësin Av. Veton Uka, si dhe të dëmtuarit F.C, O.G dhe A.U.

Prokurorja e Shtetit, në fazën e leximit të aktakuzës, ka deklaruar se pas shikimit në tërësi të shkresave të lëndës dhe aktakuzës e cila është ngritur në drejtim të të pandehurit N.C, për veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 3 e lidhur me par. 1 të KPRK-së, prokurori i shtetit tërhiqet nga ndjekja penale, respektivisht aktakuza në fjalë, pasi që veprimet e këtu të pandehurit edhe nëse të njëjtat vërtetohen përtej dyshimit të bazuar, si të tilla në asnjë rrethanë nuk përbëjnë vepër penale, pasi që fjalët “Unë me dit se kush ma ka rreh djalin, tybe nuk ka me rre ma kërkon”, nuk janë fjalë që personit tjetër të cilit i drejtohen, e paralajmërojnë për shkaktimin e një të keqe, pra në asnjë rrethanë në këto fjalë nuk mund të gjendet elementi kanosës dhe si e tillë nuk ekziston as vepra penale edhe përkundër faktit që sipas pretendimeve të palëve të dëmtuara, ka ekzistuar një konsistencë e fjalëve të të pandehurit në drejtim të tyre, kjo si e tillë prapë nuk absorbon elementet e asnjë vepre penale.

Meqenëse Prokurori i Shtetit është TËRHEQUR nga ndjeka penale kundër të pandehurit N.C, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 3 e lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe duke qenë se tërheqja është bërë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor dhe bazuar në nenin 287 par.1 të KPP-së, i cili thotë se: *“Prokurori i Shtetit mund të tërheqë aktakuzën para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, nëse paraqet njoftimin për tërheqjen nga aktakuza. Në rast të tillë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, me aktvendim e hedh aktakuzën dhe e pushon procedurën penale”*, e par.2 i të njëjtit nen i cili thotë se: *“Aktakuza e tërhequr nuk mund të paraqitet sërish nga prokurori i shtetit”*, gjykata e ka hedhe aktakuzën PP.II.nr.2179/2022 të datës 01.02.2023 dhe ka pushuar procedurën penale ndaj të pandehurit, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 3 e lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bijën në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës është marrë bazuar në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-së.

Nga se u tha më lartë e duke u bazuar në nenin 51 dhe 287 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.22/2023, datë 18.03.2025

Zyrtarja Ligjore

Arta Jusufi

Gj y q t a r i

Naim Rekalio

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tre (3) ditësh, llogaritur nga dita e pranimet të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.